

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8348
E shtunë, 25 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

AKB-ja: Reformat e vonuara rrezikojnë 882.6 milionë euro për Kosovën | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT, MË 6 GUSHT

FAQE 4-5



Ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, ka vendosur që seanca konstituive e Kuvendit të ri të dalë nga zgjedhjet e qershorit të mbahet më 6 gusht, nga ora 10:00. Haxhiu ka thënë se deri në këtë datë mbetet

detyrim politik dhe institucional i subjekteve parlamentare ta vazhdojnë dialogun për formimin e institucioneve. Afati i fundit kushtetues për seancën konstituive është më 7 gusht. Sipas aktgjykimeve të Gjykatës

Kushtetuese, nga data e seancës konstituive nis edhe periudha 60-ditore gjatë së cilës deputetët e legjislaturës së re duhet ta zgjedhin presidentin e ri, në të kundërtën vendi shkon sërish në zgjedhje

BE-ja KËRKON QË PARTITË TË MOS I BËJNË PRESION KGJK-SË PËR GJYQARËT SERBË F. 3



SHEFAT E MISIONEVE TË BE-së VIZITOJNË VERIUN, KËRKOJNË FORCIMIN E VETËQEVERISJES LOKALE F. 7



OPINION

KOSOVA DHE EVROPA E SË DREJTËS: NGA LEGJITIMITETI JURIDIK I PAVARËSISË DREJT KONSOLIDIMIT TË SUBJEKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR F. 5

Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla
BERISHA



AKTUALE



TRUMPI KËRCËNON SE DO T'I PËRDORË ASETET IRANIANE PËR T'I PAGUAR DËMET NDAJ ANIJEVE NË HORMUZ F. 2

SHPEND AHMETI DËNOHET ME DY VJET BURGIM DHE 5 000 EURO GJOBË F. 5

EKONOMI

MINISTRIA E BUJQËSISË PUBLIKON REKOMANDIME PËR FERMERËT PAS DËMEVE NGA BRESHRI F. 8

BËHEN PËRGATITJET PËR FORUMIN E TRETË EKONOMIK GJERMANO-KOSOVAR F. 8

SPORT



MALISHEVA SHKËLQEN NDAJ HIBERNIANIT, DUKAGJINI PËSON HUMBJE MINIMALE NË LUGANO F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama: Fitorja e 83 mandateve ishte bekim dhe mallkim

TIRANË, 24 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në mbledhjen e grupit parlamentar të PS-së dhe kabinetit, u shpreh se ka reflektuar në lidhje me protestën që zhvillohej tashmë prej më shumë se 50 ditësh para

zyrës së tij. Kryeministri Rama shtoi se fitorja e 83 mandateve ishte nga një anë bekim, sepse i dha forcën për ta vazhduar transformimin, por nga ana tjetër mallkim, sepse qytetarët të cilët janë ngritur në protestë,

shohin te PS shkakun e çdo gjëje që nuk shkon në vend. “Pas fitores së madhe që na dha 83 mandate, e kam thënë në disa takime me ju, ajo fitore, sa është bekim, është edhe mallkim. Bekim, sepse na dha forcën për ta vazhduar transformimin;

mallkim, sepse jo vetëm se ata shohin shkakun e çdo gjëje që nuk shkon te ne, por edhe sepse fitoret e mëdha, si ajo e qershorit të shkuar, e kthejnë në mbipeshë të përjetuar keq çdo përplasje mes realitetit dhe pritshmërive të qytetarit. Sot i



bëjmë krahasimet me Evropën e zhvilluar”, u shpreh kryeministri Edi Rama.

TRUMPI KËRCËNON SE DO T’I PËRDORË ASETET IRANIANE PËR T’I PAGUAR DËMET NDAJ ANIJEVE NË HORMUZ

UASHINGTON, 24 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump paralajmëroi se çdo dëm i shkaktuar ndaj anijeve ose anijeve të mallrave, në mes të tensioneve në Ngushticën e Hormuzit, do të kompensohet duke përdorur asetet iraniane që janë nën kontrollin e Shteteve të Bashkuara. Kjo deklaratë nxiti reagim të menjëhershëm nga Teherani. “Nga tash e tutje çdo dhe i gjithë dëmi që u shkaktohet anijeve, anijeve të mallrave apo çdo gjëje që lidhet me to, do të paguhet me paratë iraniane që Shtetet e Bashkuara i kanë në zotërim dhe i kontrollojnë”, shkroi Trumpi në platformën “Truth Social” më 24 korrik. Teherani i dënoi deklaratat e Trumpit, teksa ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araqchi, e quajti propozimin e udhëheqësit



amerikan një “precedent nxitës”. “Sekuestrimi i aseteve të një shteti tjetër për të paguar pretendime në të ardhmen që nuk kanë lidhje me to është një precedent nxitës”, shkroi Araqchi në një postim në X. Ai paralajmëroi se “ata që

festojnë ose përfitojnë nga këto fonde duhet të kujtojnë se sapo qeveritë ta normalizojnë konfiskimin, asetet e askujt nuk do të jenë më të sigurta”, duke shtuar se “kaosi që do të pasojë nuk do të jetë as i bukur dhe as paqësor”.

Këto zhvillime vijnë teksa Komanda Qendrore e ushtrisë amerikane (CENTCOM) tha se forcat e saj kanë përfunduar natën e 13-të radhazi të sulmeve ndaj Iranit, duke shtuar se Ngushtica e Hormuzit mbetet e hapur për kalim detar. “CENTCOM ka goditur komanda qendrore të ushtrisë iraniane, depo të dronëve, rrjete komunikimi, vende për vëzhgim detar dhe aftësi detare për të reduktuar edhe më shumë kërcënimi që Irani paraqet ndaj marinarëve civilë dhe anijeve tregtare që kalojnë nëpër Ngushticën e Hormuzit”, u tha në njoftimin e Komandës amerikane të publikuar në X më 24 korrik. “Rruga ujore ndërkombëtare mbetet e hapur për lundrim pavarësisht prej sulmeve të fundit nga Korpusi i

Gardës Revolucionare Islamike. Anijet tregtare vazhdojnë të lundrojnë lirshëm nëpër ngushticë me mbështetjen e ushtrisë amerikane”, shtoi CENTCOM. Tensionet mes ShBA-së dhe Iranit janë rritur, teksa një armëpushim i arritur në mes të qershorit u zhbë dhe palët rinisën sulmet pasi Uashingtoni e akuzoi Teheranin për sulme ndaj anijeve që kalojnë nëpër Ngushticën e Hormuzit. Ngushtica e Hormuzit është rrugë kyç detare, pasi nëpër të kalon një e pesta e naftës dhe gazit në botë. ShBA-ja ka thënë se Irani po e përdor këtë ngushticë si mjet presioni, duke argumentuar se ajo është një korridor ndërkombëtar që mbrohet nga e drejta ndërkombëtare.

ROKADË NË QEVERINË GJERMANE, MERZI PARAQET NDRYSHIMET NË KABINET

BERLIN, 24 KORRIK - Kancelari gjerman Friedrich Merz ka njoftuar një riorganizim të madh të kabinetit të tij të premtën përpara një serie zgjedhjesh të rëndësishme rajonale. Ky veprim vjen ndërsa Merz përpikët t’i japë jetë të re qeverisë së tij gjithnjë e më jopopullore, e cila deri më tani ka luftuar për t’i përmbushur premtimet e saj për ta nxitur ekonominë. Sondazhet e opinionit në Gjermani kanë treguar rënie të mbështetjes për Merzin dhe

rritje të mbështetjes për partinë e ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë (AfD), ndërsa sytë kthehen nga zgjedhjet e ardhshme shtetërore në Berlin, Saksoni-Anhalt dhe Mecklenburg-Vorpommern. Carsten Linnemann, i cili kishte shërbyer si sekretar i përgjithshëm i Bashkimit Kristian Demokrat (CDU) të Merzit, do ta marrë detyrën nga Nina Warken si ministër i Shëndetësisë, ndërsa Warken do ta pasojë Thorsten Frei si kreu i kancelarisë.



Frei ishte emëruar tashmë si kreu i ardhshëm i grupit parlamentar të Unionit pas dorëheqjes së Jens Spahn javën e kaluar pas një skandali zëvendësimi. Spahn dhe bashkëshorti i tij kishin njoftuar se ishin bërë prindër nëpërmjet një nëne zëvendësuese në Shtetet e Bashkuara, duke shkaktuar polemika pasi zëvendësimi është i ndaluar në Gjermani dhe është diçka që CDU ka vazhduar ta kundërshtojë. Ministri i Transportit Patrick

Schnieder thuhet se do të largohet nga detyra, siç u raportua për herë të parë nga gazeta gjermane “Bild”. Anëtar i Bundestagut Fritz Guntzler thuhet se po konsiderohet si pasardhësi i tij. Në fundjavë Merzi la të kuptohet në një intervistë se dorëheqja e Spahn mund të ofrojë një mundësi për një riorganizim të kabinetit. Merzi pritet të paraqesë detaje të mëtejshme mbi riorganizimin nesër. Priten gjithashtu ndryshime të tjera në personel.

Zjarret përfshijnë Evropën

Paris, 24 korrik - Vala e zjarreve që po godet Evropën Perëndimore vijon të përkeqësohet, duke detyruar mijëra banorë dhe turistë të braktisin shtëpitë dhe kampingjet, ndërsa Franca ka aktivizuar mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian dhe Spanja ka shpallur gjendje emergjence në rajonin e Madridit. Në jugperëndim të Francës, në

zonën pranë Bordosë, mbi 20 mijë persona janë evakuuar që prej së mërkurës, ndërsa flakët kanë përfshirë pyjet bregdetare me pisha. Zjarrfikësit, të mbështetur nga avionë që hedhin ujë, po luftojnë për të mbrojtur shtëpi e struktura turistike, ndërsa autoritetet thonë se zjarri është vënë pjesërisht nën kontroll, por mbetet ende aktiv në disa fronte.

Presidenti Macron njoftoi se Franca ka kërkuar ndihmë nga Bashkimi Evropian, ndërsa Komisioni Evropian ka dërguar tre avionë zjarrfikës për t’i mbështetur operacionet. Vetëm në rajonin e Cotignac (Kotinjak), në juglindje të vendit, janë shkatërruar rreth 25 banesa. Në jugperëndim të Francës, në zonën pranë Bordosë, mbi 20 mijë persona janë evakuuar që prej së mërkurës, ndërsa flakët

kanë përfshirë pyjet bregdetare me pisha. Zjarrfikësit, të mbështetur nga avionë që hedhin ujë, po luftojnë për të mbrojtur shtëpi e struktura turistike, ndërsa autoritetet thonë se zjarri është vënë pjesërisht nën kontroll, por mbetet ende aktiv në disa fronte. Presidenti Macron njoftoi se Franca ka kërkuar ndihmë nga Bashkimi Evropian, ndërsa



Komisioni Evropian ka dërguar tre avionë zjarrfikës për t’i mbështetur operacionet. Vetëm në rajonin e Cotignac (Kotinjak), në juglindje të vendit, janë shkatërruar rreth 25 banesa.

BE-ja KËRKON QË PARTITË TË MOS I BËJNË PRESION KGJK-SË PËR GJYQTARËT SERBË

PRISHTINË, 24 KORRIK - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë u ka bërë thirrje të gjitha partive politike në Kosovë që të përmbahen nga presioni ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Në një reagim për publikun, BE-ja kërkoi që anëtarët e KGJK-së të mos i ekspozohen presionit gjatë vendimmarrjes së tyre.

Ky reagim vjen pasi më herët gjatë ditës eksponentë të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kërkuan që anëtarët e KGJK-së të votojnë kundër kthimit të gjyqtarëve serbë që kishin paraqitur dorëheqjet e tyre më 2022. "Një sistem gjyqësor i pavarur, i paanshëm dhe apolitik është thelbësor për sundimin e ligjit në BE dhe në Kosovë", tha Zyra e BE-së.

Deputetja e zgjedhur e LV-së, Arbreshë Kryeziu-Hyseni, shkroi në rrjetet sociale se këta gjyqtarë kishin dhënë dorëheqje me urdhër të presidentit serb Aleksandar Vuçiq, duke shtuar se "tash të njëjtit - prapë me urdhër të Vuçiçit", po kërkojnë që të kthehen në detyrë. "Ka dyshime se pesë anëtarë shqiptarë në KGJK po synojnë t'i kthejnë në punë këta gjyqtarë të Vuçiçit, edhe pse është komplet e kundërligjshme", shkroi ajo, duke kërkuar që kjo të mos ndodhë dhe dorëheqjet të procedohen tek ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu.

Deputetja tjetër e zgjedhur e LV-së, Adriana Matoshi, po ashtu kërkoi që KGJK-ja të marrë vendim kundër kthimit të gjyqtarëve serbë në detyrë, sikurse edhe deputeti tjetër i zgjedhur, Mefail Bajqinovci. Madje Bajqinovci tha se edhe



kreu i KGJK-së, Rrustem Thaqi, duhet të deklarohet publikisht që kthimi i tyre nuk duhet të lejohet, duke e cilësuar "shkelje" nëse veprohet ndryshe.

Tashmë shtatë prokurorë dhe staf administrativ serb janë liruar nga detyra, pasi Haxhiu më 21 korrik nënshkroi dekretet për lirim të tyre.

Më 21 korrik ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, nënshkroi dekretet për lirim nga detyra të shtatë prokurorëve serbë që kishin dhënë dorëheqje në fund të vitit 2022 në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës.

Dekreti u nënshkrua një ditë pasi Këshilli Prokurorial i Kosovës refuzoi kërkesën e pesë prokurorëve serbë dhe 15 punonjësve administrativë të Prokurorisë Themelore në

Mitrovicë për t'i tërhequr dorëheqjet e tyre.

Vendimi për lirim nga detyra të prokurorëve u kritikua nga BE-ja.

Rreth 130 prokurorët dhe gjyqtarët serbë kishin dhënë dorëheqje në fund të nëntorit 2022, në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës në katër komunat me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Ky veprim - i nxitur nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, që mbështetet nga Beogradi - erdhi në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i hequr nga përdorimi targat e automjeteve të lëshuara nga Serbia dhe për t'i zëvendësuar ato me targa të Kosovës. Por, çështja e dorëheqjeve të pazgjidhura u

rikthye në vëmendje pasi, në mes të qershorit, Haxhiu kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës që "pa vonesa" t'i përmbyllin procedurat lidhur me këto dorëheqje, duke argumentuar se zvarritja e tyre ndikon në funksionimin normal të sistemit të drejtësisë.

Haxhiu: KGJK të mos bie pre e ndikimeve për gjyqtarët serbë

Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, i bëri thirrje Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) që të mos bie pre e ndikimeve të askujt, qoftë vendore apo ndërkombëtare, dhe t'i dërgojë asaj kërkesën për lirim nga detyra të gjyqtarëve serbë që dhanë dorëheqje vite më parë. Në një konferencë për medie në

Prishtinë, Haxhiu tha se KGJK-ja, në bazë të legjislacionit në fuqi, nuk ka kompetencë që t'i kthejë gjyqtarët serbë në punë, pasi ata ofruan dorëheqje më 2022, duke kështilluar që KGJK-ja ta ndjekë shembullin e Këshillit Prokurorial të Kosovës që i kërkoi asaj të lirojë nga detyra prokurorët dhe stafin administrativ serb. "Imagjinoni të kemi gjyqtarë dhe prokurorë që u binden urdhrave të një shteti tjetër", tha Haxhiu.

Ajo kërkoi nga KGJK-ja që gjatë mbledhjes së sotme t'i respektojë ligjet dhe t'i dërgojë asaj propozimin për lirim nga detyra të gjyqtarëve serbë që kishin dhënë dorëheqje më 2022.

Ajo, po ashtu, kritikoi faktorin ndërkombëtar, duke thënë se po bën "presion" mbi KGJK-në dhe KPK-në për çështjen e dorëheqjeve. "Kush nga partnerët tanë ndërkombëtarë, që sot bëjnë presione mbi këshillat, kush nga ta do të lejonte që në shtetet e tyre të kenë gjyqtarë dhe prokurorë që dirigjohen nga një shtet tjetër", tha Haxhiu, duke pyetur se kush nga ndërkombëtarët do të kërkonte nga këshillat që të veprojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Haxhiu tha se pas aktit të dorëheqjes nuk është në vullnetin politik e as në vendimet e këshillave të zhbëhet ky vendim. "Dorëheqja është akt juridik që sjellë përfundimin e mandatit dhe pasi ky efekt është prodhuar, ligji nuk parashihet asnjë mekanizëm për rikthimin në të njëjtin mandat. Legjislacioni në fuqi nuk i jep asnjë kompetencë ligjore as KPK-së, as KGJK-së që t'i anulojë pasojat e dorëheqjes apo të rivendosë një mandat që ka përfunduar", tha Haxhiu.

KONJUFCA FALËNDERON AMBASADORIN SUEDEZ PËR KONTRIBUTIN NË FORCIMIN E MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SUEDI

PRISHTINË, 24 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës në detyrë, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund.

Gjatë takimit zëvendëskryeministri Konjufca e falënderoi ambasadorin Westerlund për angazhimin dhe kontributin gjatë mandatit diplomatik si dhe për rolin në avancimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë. Zëvendëskryeministri Konjufca

vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Suedisë për Kosovën dhe bashkëpunimin e saj në fusha të rëndësishme për zhvillimin e vendit. Ai theksoi rëndësinë e vazhdim të partneritetit ndërmjet dy vendeve, përfshirë në kuadër të perspektivës evropiane të Kosovës dhe të zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik.

Në përfundim zëvendëskryeministri Konjufca i uroi ambasadorit Westerlund suksese në angazhimet e tij të ardhshme dhe shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e mirë gjatë mandatit të tij në Kosovë.





SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT, MË 6 GUSHT

Ushtruesja e detyrës e presidentit, Albulena Haxhiu, ka vendosur që seanca konstituive e Kuvendit të ri të dalë nga zgjedhjet e qershorit të mbahet më 6 gusht, nga ora 10:00. Haxhiu ka thënë se deri në këtë datë mbetet detyrim politik dhe institucional i subjekteve parlamentare ta vazhdojnë dialogun për formimin e institucioneve. Afati i fundit kushtetues për seancën konstituive është më 7 gusht. Sipas aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, nga data e seancës konstituive nis edhe periudha 60-ditore gjatë së cilës deputetët e legjislaturës së re duhet ta zgjedhin presidentin e ri, në të kundërtën vendi shkon sërish në zgjedhje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, njëherësh kryetare e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ka njoftuar të premten se seanca konstituive e Kuvendit të Republikës së Kosovës do të mbahet më 6 gusht në orën 10:00. "Prandaj, sot ju njoftoj se seanca konstituive e Kuvendit të Republikës së Kosovës do të mbahet më 6 gusht në orën 10:00. Deri atëherë mbetet detyrim politik dhe institucional i subjekteve parlamentare që ta vazhdojnë dialogun. Dialogu ndërmjet tyre nuk duhet të

shihet si shenjë dobësie, por si dëshmi e përgjegjësisë demokratike", theksoi Haxhiu në një konferencë për medie. Haxhiu tha se më 8 korrik, një muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Me këtë rast, ajo shprehu mirënjohjen për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, stafin e KQZ-së dhe institucionet e angazhuara për mbarrëvajtjen e procesit zgjedhor. Sipas saj, zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë demokratike dhe të qetë, duke konfirmuar edhe një herë pjekurinë e demokracisë në Kosovë.

"Pas certifikimit të rezultateve, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton qartë se Presidenti e thërret seancën konstituive të Kuvendit brenda afatit prej 30 ditësh. Po ashtu, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e ka sqaruar qartë se vetëm pas konstituimit të Kuvendit fillojnë të rrjedhin afatet kushtetuese që lidhen me procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe, siç e dini, ato janë 60 ditë", tha Haxhiu. Pikërisht për shkak të kësaj lidhjeje kushtetuese ndërmjet konstituimit të Kuvendit dhe procedurës së zgjedhjes së presidentit, Haxhiu tha se e ka vlerësuar me kujdes çdo hap të

ndërmarrë gjatë këtyre javëve. "Kam mirëpritur ftesat për takime të kryeministrit dhe kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje!, Albin Kurti, dhe kam ndjekur nga afër përpjekjet për të arritur një marrëveshje. Duke qenë se ende nuk ekziston një dakordim politik për çështjen e Presidentit, kam vendosur ta shfrytëzoj afatin që e lejon Kushtetuta për t'u krijuar partive politike hapësirën e nevojshme për dialog dhe për ndërtimin e një konsensusi", u shpreh Haxhiu. Ajo tha më tej se, në një demokraci parlamentare, përgjegjësia për ndërtimin e institucioneve nuk është ekskluzivitet i askujt, por u takon të gjithëve, duke shtuar se marrëveshja kërkon gatishmëri dhe seriozitet nga të gjitha palët. Sipas Haxhiut, palët duhet të shprehin vullnet për dialog dhe thirrjes së ofertave duhet t'u përgjigjen me përgjegjësinë më të lartë. Ajo shtoi se dialogu nuk mund të jetë një proces njëkahësh dhe as përgjegjësia nuk mund të jetë e njëanshme. "Prandaj, bëj thirrje që, në ditët në vijim, të intensifikohet komunikimi dhe

të dëshmohej pjekuri politike, sepse qytetarët presin nga të gjithë ne zgjidhje. Ata presin institucione funksionale dhe që përgjegjësia shtetërore të vendoset mbi dallimet politike. Pra, qytetarët presin zgjidhje dhe jo zgjedhje. Natyrisht, jam e vetëdijshme për sfidat e brendshme të subjekteve politike, por po ashtu duhet të kemi të qarta edhe afatet kushtetuese, të cilat nuk presin. Qytetarët kanë votuar që institucionet të krijohen, të funksionalizohen dhe të punojnë për ta", theksoi Haxhiu, duke shtuar se vullneti i qytetarëve duhet të manifestohet në institucione të reja e legjitime dhe se Republika e Kosovës nuk mund të mbetet peng i inateve apo bllokadave. "Shmangia e një bllokade të zgjatur institucionale është përgjegjësi e të gjithëve. Po ashtu, shmangia e zgjedhjeve të parakohshme duhet të jetë një objektiv i përbashkët, sepse qytetarët kanë dhënë verdiktin e tyre dhe presin që ai të materializohet në institucione funksionale, e jo në një cikël të ri paqartësie politike", përfundoi kryetaria Haxhiu.

ISH-KRYETARI I PRISHTINËS DËNOHET ME DY VJET BURGIM DHE 5 000 EURO GJOBË



PRISHTINË, 24 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë e gjeti fajtor ish-kreun e Prishtinës, Shpend Ahmeti, për mosdeklarim të saktë të pasurisë, duke e dënuar me dy vjet burgim dhe pesë mijë euro gjobë.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, ndërkaq gjoba duhet të paguhet brenda tre muajsh pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm, tha kreu i trupit gjykues, Leon Perllaska, raporton “Betimi për Drejtësi”. Megjithatë,

Gjykata refuzoi kërkesën e Prokurorisë Speciale për konfiskimin e pasurisë së padeklaruar në vlerë prej 172 600.00 eurosh.

Një ditë më parë para Gjykatës Themelore, Ahmeti u deklarua i pafajshëm dhe tha se shuma prej 172 600.00 eurosh ishte ndihmë financiare nga familja e tij, duke theksuar se disa herë i është nënshtruar kontrollit të pasurisë nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Në dhjetor të vitit 2025 Prokuroria Speciale ngriti

aktakuzë ndaj Ahmetit për mosraportim apo raportim të rremë të pasurisë. Sipas aktakuzës, Ahmeti, i cili shërbeu kryetar i Prishtinës për dy mandate, nga viti 2013 deri më 2021, kishte paraqitur “me dashje” deklarata të pasakta të pasurisë pasi, sipas Prokurorisë, nuk kishte deklaruar deponimet në para të gatshme nga 2018 deri në vitin 2022. “Sipas aktakuzës, shuma e përgjithshme e mjeteve të padeklaruar arrin vlerën prej 172 600.00 eurosh”, tha më 23 dhjetor 2025.

Mosdeklarimi i pasurisë, sipas Kodit Penal të Kosovës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, ndërsa deklarimi i rremë i pasurisë është i dënueshëm me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Në Kosovë që nga viti 2007 zyrtarët publikë duhet të deklarojnë çdo vit pasurinë.

Më pas Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zgjedh një numër të caktuar të zyrtarëve publikë të cilëve ua verifikon pasurinë e deklaruar. Ligji për Deklarimin e Pasurisë i

obligon zyrtarët e lartë publikë ta deklarojnë pasurinë e tyre 30 ditë nga marrja e postit të ri, pastaj çdo vit.

Deri më tani asnjë zyrtar nuk ishte dënuar me burgim për mosdeklarim të pasurisë.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, është dënuar në fund të vitit 2022 me gjobë prej 700 eurosh nga Gjykata Themelore në Prishtinë për shkak të mosdeklarimit të pasurisë për vitin 2020 brenda afatit ligjor.

Më herët u. d. presidentja kishte mohuar të ketë pasur ndonjë marrëveshje mes Kurtit e Abxhixhikut për formim të institucioneve, përfshirë çështjen e presidentit. “Nuk ka pasur marrëveshje. Po të kishte marrëveshje sigurisht që do ta bënim publike. Në takim ka qenë kryeministri Kurti dhe ministri i Financave, Hekuran Murati, dhe në anën tjetër z. Abdixhiku dhe znj. Osmani-Sadriu. Ka pasur diskutime për rrugën që do ta ndjekim përpara, por jo marrëveshje”, ishte shprehur Haxhiu.

Pikërisht për shkak të mosarritjes së konsensusit mes partive muaj më parë, vendi mbajti zgjedhje të parakohshme parlamentare në qershor - të tretat brenda një viti e gjysmë. Caktimi i datës për seancën konstituive vjen në kohën kur bisedimet për një marrëveshje të mundshme për krijimin e institucioneve mes partisë fituese të zgjedhjeve, Lëvizjes Vetëvendosje, dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës janë

pezulluar.

Më 15 korrik kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, tha se ishte i detyruar t'i pezullonte diskutimet me kreun e LV-së, njëherësh kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, pasi në LDK ka një nismë për shkarkimin e tij nga kreu i partisë.

Më 10 korrik Kurti u takua ndarazi me Abdixhikun dhe me kreun e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza. Përderisa Hamza tha pas takimit se partia e tij do të mbetej në opozitë, Abdixhiku shprehu gatishmëri për vazhdimin e takimeve.

LDK-ja ende nuk ka njoftuar se kur do të mund të mbahet Kuvendi i partisë në të cilin do të diskutohet për nismën për shkarkimin e Abdixhikut. Vetë Abdixhiku e ka kritikuar këtë nismë duke thënë se rrezikon që ta lërë vendin pa institucione dhe mund të nxisë zgjedhje të reja në vjeshtë.

Partia në pushtet, LV-ja e Kurtit, sipas rezultatit të certifikuar, i ka fituar 53 mandate, PDK i ka

fituar 22 ulëse, LDK 18 ulëse dhe Aleanca shtatë ulëse.

Për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e qeverisë së re nevojiten 61 vota në Kuvendin prej 120 ulësesh.

Partia e Kurtit, së bashku me partitë nga komunitetet pakicë joserbe, i kanë numrat e nevojshme për këto dy procese. Por, për presidentin kërkohet një marrëveshje politike, pasi duhet prania e 80 deputetëve në dy raundet e para të votimit.

Me një marrëveshje të mundshme me LDK-në, e cila i ka 18 deputetë, atëherë do të arriheshin të paktën 81 vota, të mjaftueshme për zgjedhjen e presidentit të ri, nëse të paktën 80 prej tyre do të qëndronin në sallë në dy raundet e para të votimit.

Nëse presidenti nuk zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit, atëherë organi ligjvënës shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja.

Nëse Kosova mban sërish zgjedhje, atëherë ato do të ishin

votimet e katërta parlamentare që nga shkurti i vitit të kaluar.

Cakolli: Caktimi i seancës konstituive për 6 gusht, përveçse veprim i vonuar, edhe institucionalisht i papërgjegjshëm

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar se caktimi i seancës konstituive për 6 gusht, përveçse është veprim i vonuar, është edhe institucionalisht i papërgjegjshëm. Ai ka thënë se pjesa më problematike e caktimit të seancës më 6 gusht lidhet me afatin 60-ditor për zgjedhjen e presidentit. “Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se, në rrethanat kur Kuvendi ende nuk është konstituuar, ky afat fillon nga konstituimi i tij. Kjo do të thotë se 6 gushti e aktivizon afatin, 7 gushti llogaritet si dita e parë, ndërsa 5 tetori është dita e 60-të

dhe, rrjedhimisht, dita e fundit për zgjedhjen e presidentit. Në anën tjetër, më 4 tetor përfundon periodha gjashtëmuajore e ushtrimit të detyrës së presidentit. Nëse procedura e zgjedhjes së presidentit shkon deri në ditën e 60-të, pra më 5 tetor, dhe eventualisht dështon, atëherë Kuvendi do të shpërndahet pasi që periodha e ushtrimit të detyrës së presidentit tashmë të ketë përfunduar. Kjo do të thotë se mund të mbetemi njëkohësisht pa Kuvend dhe pa ushtrues detyre të presidentit, që është i vetmi funksion me mandat kushtetues për ta formalizuar shpërndarjen e Kuvendit, për ta caktuar datën e zgjedhjeve të reja dhe, pas tyre, për ta propozuar mandatarin për kryeministër. Aq më keq që, koha që u tha se po lihet në dispozicion për negociata rreth zgjedhjes së presidentit po kalon jo vetëm pa marrëveshje politike, por edhe pa asnjë raund të ri takimesh ndërpartiake”, ka deklaruar Cakolli.

KOSOVA DHE EVROPA E SË DREJTËS: NGA LEGJITIMITETI JURIDIK I PAVARËSISË DREJT KONSOLIDIMIT TË SUBJEKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR



Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Kosova në dritën e së drejtës ndërkombëtare dhe rendit juridik evropian

Historia moderne e marrëdhënieve ndërkombëtare dëshmon se krijimi dhe konsolidimi i shteteve nuk janë vetëm procese politike, por procese të ndërlikuara juridike, historike dhe institucionale. Në këtë kuadër, Republika e Kosovës përbën një nga rastet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare të shekullit XXI, sepse në të ndërthuren çështjet e vetëvendosjes, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ndërhyrjes ndërkombëtare dhe funksionimit të institucioneve juridike globale.

Kosova nuk është rezultat i një akti të izoluar politik, por i një procesi të gjatë historik që lidhet me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, diskriminimin institucional, shkeljet masive të të drejtave themelore dhe konfliktin e viteve 1998 - 1999. Pas ndërhyrjes ndërkombëtare dhe përfundimit të konfliktit, Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara krijoi një regjim të përkohshëm administrimi ndërkombëtar, duke hapur rrugën për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe përcaktimin e statusit përfundimtar.

Shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 shënoi një moment vendimtar në historinë e Kosovës. Megjithatë, çështja themelore për bashkësinë ndërkombëtare ishte nëse ky akt ishte në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare. Pikërisht kjo çështje u vendos para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, organit kryesor gjyqësor të Kombeve të Bashkuara.

Opinion i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë: legjitimiteti juridik i pavarësisë së Kosovës

Opinion i Këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i shpallur më 22 korrik 2010, përbën momentin më të rëndësishëm juridik në trajtimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Për herë të parë, institucioni më i lartë gjyqësor i Kombeve të Bashkuara shqyrtoi përputhshmërinë e deklaratës së

pavarësisë së Kosovës me të drejtën ndërkombëtare. Kërkesa iu paraqit Gjykatës nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së përmes Rezolutës 63/3 të vitit 2008, me pyetjen nëse deklarata e njëanshme e pavarësisë ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Gjykata e kufizoi analizën e saj vetëm në këtë çështje juridike dhe nuk u shpreh mbi detyrimin e shteteve për njohje, mbi statusin politik përfundimtar apo mbi marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Pas shqyrtimit të normave ndërkombëtare dhe praktikës së shteteve, Gjykata konstatoi se e drejta e përgjithshme ndërkombëtare nuk përmbante ndonjë ndalim të aplikueshëm ndaj deklaratave të pavarësisë. Për rrjedhojë, shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk përbënte shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

Ky përfundim pati rëndësi të jashtëzakonshme juridike, sepse eliminoi pretendimin se vetë akti i pavarësisë ishte i paligjshëm. Në këtë mënyrë, debati ndërkombëtar u zhvendos nga çështja e ligjshmërisë së ekzistencës së Kosovës drejt çështjeve të njohjes diplomatike, integritimit ndërkombëtar dhe konsolidimit të subjektivitetit të saj.

Gjykata analizoi gjithashtu raportin ndërmjet deklaratës së pavarësisë dhe Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Ajo arriti në përfundimin se deklarata e pavarësisë nuk ishte në kundërshtim me këtë rezolutë, duke vlerësuar se zhvillimet politike dhe juridike që çuan në krijimin e institucioneve të reja të Kosovës duhet të kuptohen në kontekstin e veçantë historik të saj.

Megjithatë, Opinioni i GJND-së bëri një dallim të rëndësishëm ndërmjet ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë dhe njohjes së një shteti nga shtetet e tjera. Nëse çështja e parë u sqarua nga Gjykata, çështja e dytë mbeti në fushën e vendimmarrjes sovrane të shteteve.

Në këtë kuptim, Opinioni i vitit 2010 krijoi bazën më të rëndësishme juridike për legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe përbën një pikë kthese në procesin e konsolidimit të saj si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Pesë shtetet mosnjohëse të Bashkimit Evropian: ndërmjet interesave kombëtare dhe koherencës evropiane

Pavarësisht konfirmimit juridik nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe njohjes nga një numër i madh shtetesh, pesë

vende anëtare të Bashkimit Evropian - Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja - vazhdojnë të mos e njohin Republikën e Kosovës.

Nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, duhet dalluar ndërmjet ekzistencës së një shteti dhe aktit politik të njohjes së tij. E drejta ndërkombëtare nuk imponon një detyrim automatik për njohje, pasi ajo mbetet një vendim sovran i çdo shteti. Megjithatë, pas Opinioni të GJND-së, mosnjohja nuk mund të mbështetet më në pretendimin se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte juridikisht e paligjshme.

Qëndrimet e këtyre shteteve lidhen kryesisht me faktorë të politikës së brendshme dhe konsiderata strategjike. Spanja e ka lidhur qëndrimin e saj me çështjet kushtetuese dhe shqetësimet për lëvizjet separatiste; Rumania dhe Sllovakia me çështjet e pakicave kombëtare; Qiproja me situatën e saj të ndarjes territoriale; ndërsa Greqia ka mbajtur një qasje të kujdesshme, duke zhvilluar njëkohësisht marrëdhënie praktike me Kosovën.

Megjithatë, rasti i Kosovës nuk mund të barazohet automatikisht me situata të tjera, sepse ai është formësuar nga rrethana të veçanta historike: konflikti i armatosur, ndërhyrja ndërkombëtare, administrimi i OKB-së dhe procesi i gjatë diplomatik për përcaktimin e statusit.

Kjo situatë paraqet një sfidë për Bashkimin Evropian, i cili synon të jetë një aktor ndërkombëtar i bazuar në sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare. Çështja e Kosovës prek drejtpërdrejt koherencën e politikës së jashtme evropiane dhe aftësinë e BE-së për të harmonizuar vlerat e tij me realitetet politike të kontinentit.

Jurisprudenca ndërkombëtare dhe karakteri sui generis i rastit të Kosovës

Rasti i Kosovës duhet të analizohet edhe në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare dhe praktikës së institucioneve ndërkombëtare për çështjet e vetëvendosjes, administrimit ndërkombëtar dhe krijimit të shteteve të reja. Historia e marrëdhënieve ndërkombëtare dëshmon se shtetformimi nuk ndjek një model të vetëm, por është rezultat i ndërthurjes së faktorëve juridikë, historikë dhe politikë.

Opinion i Këshillimor për Namibinë i vitit 1971 përbën një shembull të rëndësishëm të rolit

të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në interpretimin e situatave komplekse ndërkombëtare.

Gjykata konstatoi se vazhdimi i administrimit të Namibisë nga Afrika e Jugut ishte i paligjshëm dhe se shtetet kishin detyrimin të mos e njohnin atë situatë. Ky rast dëshmoi ndikimin e madh juridik dhe politik të opinionëve këshillimorë të Gjykatës.

Në rastin e Saharasë Perëndimore (1975), Gjykata theksoi rëndësinë e parimit të vetëvendosjes dhe nevojën që statusi i një territori të vlerësohet mbi bazën e rrethanave konkrete historike dhe politike. Ky parim është i rëndësishëm edhe për analizën e Kosovës, pasi dëshmon se e drejta ndërkombëtare nuk mund të zbatohet përmes krahasimeve mekanike ndërmjet rasteve të ndryshme.

Përvojat e Timorit Lindor dhe Sudanit të Jugut tregojnë gjithashtu se bashkësia ndërkombëtare ka luajtur rol vendimtar në proceset e tranzicionit politik dhe krijimit të shteteve të reja. Në të dy rastet, administrimi ndërkombëtar, marrëveshjet politike dhe ndërtimi institucional shërbyen si ura drejt konsolidimit të shtetësisë.

Në këtë kuadër, Kosova paraqet një rast të veçantë (sui generis). Veçoritë e saj lidhen me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, diskriminimin sistematik, konfliktin e armatosur, ndërhyrjen ndërkombëtare, administrimin e OKB-së dhe procesin shumëvjeçar të përcaktimit të statusit. Për këtë arsye, rasti i Kosovës nuk krijon një precedent automatik për raste të tjera, por duhet kuptuar si një zhvillim specifik i së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore.

Bashkimi Evropian dhe e ardhmja e Kosovës: nga legjitimiteti juridik drejt integritetit strategjik

Sot, sfida kryesore e Kosovës nuk është më legjitimiteti juridik i shpalljes së pavarësisë, por konsolidimi i plotë i pozitës së saj në rendin ndërkombëtar dhe integrimi në strukturat evropiane dhe euroatlantike.

Bashkimi Evropian ka një rol të veçantë në këtë proces. Si një projekt i ndërtuar mbi paqen, demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e normave ndërkombëtare, BE-ja përballet me sfidën për të harmonizuar parimet e saj themelore me realitetet politike të Ballkanit Perëndimor.

Kosova sot funksionon si shtet me institucione kushtetuese, territor, popullsi të përhershme dhe aftësi për të zhvilluar marrëdhënie ndërkombëtare. Ajo ka ndërtuar një sistem

institucional dhe ka krijuar një numër të gjerë marrëdhëniesh diplomatike. Në këtë kuptim, çështja kryesore nuk është krijimi i shtetit, por përmbyllja e procesit të integritetit të tij të plotë në mekanizmat ndërkombëtarë.

Për Bashkimin Evropian, integrimi i Kosovës nuk duhet parë vetëm si çështje e një shteti të veçantë, por si pjesë e stabilitetit afatgjatë të Evropës. Një Ballkan Perëndimor i integruar kontribuon në sigurinë evropiane, në forcimin e rendit juridik dhe në zvogëlimin e hapësirave për ndikime destabilizuese.

Në këtë drejtim, çështja e Kosovës është edhe një provë për kredibilitetin e vetë Evropës. Një Evropë e së drejtës duhet të jetë në gjendje të lidhë realitetet politike me parimet juridike mbi të cilat është ndërtuar. Kjo nuk nënkupton cenimin e sovranitetit të shteteve anëtare për të vendosur mbi njohjen, por kërkon një reflektim strategjik mbi interesat afatgjata të kontinentit.

Rasti i Kosovës përfaqëson një nga zhvillimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare dhe të historisë politike evropiane të shekullit XXI. Ai dëshmon se krijimi dhe konsolidimi i shteteve janë procese ku ndërthuren ligji, historia dhe realiteti politik.

Opinion i Këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i vitit 2010 krijoi një bazë të fuqishme juridike duke konfirmuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Pas këtij momenti, sfida kryesore u zhvendos nga çështja e ligjshmërisë drejt procesit të njohjes, integritetit dhe konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar.

Kosova nuk kërkon trajtim jashtë rregullave të rendit ndërkombëtar, por kërkon që realiteti i saj shtetëror të vlerësohet mbi bazën e zhvillimeve historike, juridike dhe institucionale. Në të njëjtën kohë, ajo ka përgjegjësi të vazhdojë forcimin e shtetit të së drejtës, demokracisë dhe institucioneve funksionale.

Në fund, çështja e Kosovës është edhe një provë për Evropën: nëse ajo do të arrijë të ndërtojë një rend të bazuar në koherencë juridike, vizion politik dhe përgjegjësi historike. Një Evropë e bashkuar nuk ndërtohet duke ruajtur ndarjet e së kaluarës, por duke integruar realitetet e reja në një hapësirë të përbashkët të paqes, ligjit dhe bashkëpunimit.

Kosova është tashmë pjesë e realitetit politik evropian; sfida e mbetur është që ky realitet të marrë formën e tij të plotë juridike dhe institucionale në Evropën e bashkuar.

Nis rehabilitimi i zonave të degraduara në pellgun e Drinit të Bardhë

Prishtinë, 24 korrik - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, ka bërë me dije se ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me përfaqësuesit e CNVP-së, duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe

rehabilitimit të zonave të degraduara përgjatë pellgut të lumit Drini i Bardhë. “Ky partneritet forcon angazhimin tonë për mbrojtjen e burimeve natyrore, rikthimin e ekosistemeve të dëmtuara dhe ndërtimin e një mjedisi më të qëndrueshëm për qytetarët tanë”,

ka njoftuar Pacolli. Përmes këtij projekti do të rehabilitohen mbi 5 hektarë tokë të degraduar; Do të realizohen mbjellje të reja për ripyllëzimin e zonave të dëmtuara; Do të mbrohet biodiversiteti dhe ekosistemet natyrore dhe do të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit

për rëndësinë e pyjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. “Ne do të vazhdojmë të mbështesim iniciativa që garantojnë zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim të përgjegjshëm të pasurive natyrore dhe një të ardhme më të gjelbër për Kosovën”, ka deklaruar ministria Pacolli.



SHEFAT E MISIONEVE TË BE-së VIZITOJNË VERIUN, KËRKOJNË FORCIMIN E VETËQEVERISJES LOKALE

Zveçan, 24 korrik - Shefat e Misioneve të BE-së kanë vizituar Zveçanin. Ata janë takuar me kryetarët e katër komunave veriore të Kosovës dhe me ta kanë diskutuar për funksionimin e qeverisjes lokale dhe ushtrimin e kompetencave të tyre tetë muaj pas marrjes së detyrës, pas zgjedhjeve lokale të tetorit 2025. Kryetarët e komunave paraqitën një sërë sfidash që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve komunale, përfshirë mungesën e arkivave, mungesën e stafit të kualifikuar, kufizimet buxhetore, çështjet pronësore dhe kontrollin nga niveli qendror mbi aktivitetet komunale.

Shefat e Misioneve të BE-së zhvilluan gjithashtu takime të ndara me përfaqësues të shoqërisë civile dhe anëtarë të kuvendeve komunale nga partitë opozitare. “Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare mbeten fuqimisht të përkushtuara ndaj një vetëqeverisjeje lokale të fortë në Kosovë dhe decentralizimit të mbështetur në Kushtetutë dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Ata bëjnë thirrje për përmirësimin e koordinimit ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror, mbështetje efektive për komunat nga ministritë përkatëse dhe zbatim të barabartë të parimeve të



sundimit të ligjit në mbarë Kosovën. Administratat komunale efektive, llogaridhënëse dhe plotësisht funksionale, që ofrojnë shërbime cilësore për të gjithë banorët e Kosovës, përfshirë në veri, janë në interes të publikut dhe thelbësore për ndërtimin e besimit, stabilitetit dhe prosperitetit. Si partneri më i fortë dhe më i besueshëm i Kosovës, si dhe donatori më i madh i asistencës financiare, Bashkimi Evropian do të vazhdojë të mbështesë komunat dhe reformat që forcojnë vetëqeverisjen lokale në mbarë Kosovën”, ka njoftuar Zyra e BE-së në Kosovë.

AKK-ja DO TË OFROJË MBËSHTETJE TEKNIKE PËR KOMUNAT PËRFITUESE TË PROJEKTIT “FUQIZIMI I DEMOKRACISË PJESËMARRËSE”



PRISHTINË, 24 KORRIK - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka filluar zyrtarisht procesin e ofrimit të mbështetjes teknike dhe mentorimit për komunën e Gjilanit, komunën e Obiliqit dhe komunën e Shtimes të cilat janë përzgjedhur përfituese në kuadër të projektit “Fuqizimi i demokracisë pjesëmarrëse”. Përmes kësaj mbështetjeje AKK do të punojë ngushtë me komunat për zbatimin e Rregullores MF Nr. 04/2017 për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile; aplikimin praktik të Metodologjisë LOD; përmirësimin e proceseve komunale të financimit të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve); forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së menaxhimit të fondeve publike. Si hap i parë i këtij procesi, AKK-ja ka zhvilluar takime fillestare

me ekipet teknike pesanëtarëshe të emëruara nga kryetarët e komunave përfituese. Gjatë këtyre takimeve janë paraqitur objektivat e mbështetjes teknike, metodologjia e punës, rolet dhe përgjegjësitë e ekipeve komunale. Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Fuqizimi i demokracisë pjesëmarrëse”, i cili zbatohet nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) me mbështetjen e UNDP-së përmes Programit ReLoaD3 dhe financohet nga Bashkimi Evropian. Mbështetja teknike dhe mentorimi do të ofrohen deri në maj të vitit 2028, me synim forcimin e kapaciteteve institucionale të komunave dhe avancimin e praktikave transparente dhe të standardizuara në financimin publik të organizatave të shoqërisë civile.

Kurti pret në takim Hykollin, ofron bashkëpunimin e qeverisë për punëtorët

Prishtinë, 24 korrik - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pritur në takim kryetarin e rizgjedhur të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykolli, të cilin e ka uruar për mandatin e ri dhe i ka ofruar

bashkëpunimin e qeverisë me qëllim të mbrojtjes, forcimit dhe zbatimit të të drejtave të punëtorëve. Kurti ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar dhe e përkushtuar për

përmirësimin e pozitës dhe kushteve të punëtorëve. “Kjo dëshmohet nëpërmjet rritjes së pagës minimale, formalizmit, shtimit të numrit të inspektorëve dhe plotësimit të legjislacionit përkatës”, ka theksuar Kurti.



AKB-ja: REFORMAT E VONUARA RREZIKOJNË 882.6 MILIONË EURO PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 24 KORRIK - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka thënë se fakti që Kosova ishte vendi i fundit në rajon që dorëzoi raportin për zbatimin e reformave, vetëm në momentet e fundit para skadimit të afatit, dëshmon mungesë të planifikimit strategjik, koordinimit institucional dhe përgjegjësisë ndaj një procesi me rëndësi jetike për zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian të vendit. Sipas tij, Kosova ka në dispozicion 882.6 milionë euro nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian për periudhën 2024-2027. “Deri më tani vendi ka përfituar vetëm 61 milionë euro në formë parafinancimi, që përfaqësojnë rreth 7 % të shumës së përgjithshme, ndërsa ende nuk ka marrë asnjë pagesë të rregullt.

Ndërkohë, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi kanë përfituar tashmë disa këste financimi. Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor rrezikojnë të mos përfitojnë deri në 700 milionë euro nga Plani i Rritjes nëse reformat nuk zbatohen brenda afateve të përcaktuara. Nëse Kosova vazhdon me ritmin aktual të ngadalshëm dhe me vonesa në përmbushjen e obligimeve, rrezikon të humbasë një pjesë të konsiderueshme të fondeve që i takojnë dhe që janë jetike për zhvillimin ekonomik, investimet publike, sektorin privat dhe mirëqenien e qytetarëve”, ka thënë ai. Drejtuesi i AKB-së vlerëson se këto vonesa nuk janë thjesht çështje administrative. “Ata



përkthehen në më pak investime, më pak vende të reja pune, më pak mbështetje për bizneset dhe në ngadalësim të procesit të integritimit evropian të Kosovës”, është shprehur Shahini. Ai ka theksuar se Kosova nuk ka luksin të humbasë asnjë euro nga fondet e Bashkimit Evropian. “Çdo afat i humbur

është një mundësi e humbur për zhvillimin ekonomik të vendit. Qeveria duhet të veprojë me urgjencë, profesionalizëm dhe përgjegjësi për t'i përmbushur të gjitha reformat, në mënyrë që fondet evropiane të mos mbeten vetëm premtime, por të shndërrohen në investime konkrete për qytetarët, bizneset

dhe ekonominë e Kosovës. AKB i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që urgjentisht, të hartojë dhe zbatojë një plan dinamik për realizimin e reformave, me afate të qarta, përgjegjësi institucionale dhe transparencë të plotë, në mënyrë që Kosova të mos mbetet vendi i fundit në rajon për përfitimin e fondeve të Bashkimit Evropian”, ka deklaruar Shahini.

AKB-ja rithekson se fondet e Bashkimit Evropian përbëjnë një mundësi historike për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Humbja e tyre do të kishte pasoja të drejtpërdrejta për ekonominë, sektorin privat, punësimin dhe perspektivën evropiane të vendit. “Prandaj, përmbushja e reformave duhet të jetë prioritet kombëtar dhe institucional”, ka thënë Shahini.

MINISTRIA E BUJQËSISË PUBLIKON REKOMANDIME PËR FERMERËT PAS DËMEVE NGA BRESHËRI

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka publikuar një varg rekomandimesh për fermerët lidhur me trajtimin e pemëve frutore pas dëmtimeve të shkaktuara nga breshëri. Sipas Ministrisë, pas goditjes nga breshëri, prioritet kryesor është mbrojtja e plagëve të krijuara në bimë, parandalimi i infeksioneve dhe ndihma në rikuperimin e kulturave bujqësore. Në rekomandimet e publikuara, MBPZHR ka këshilluar fermerët që fillimisht të aplikojnë preparate me bazë bakri për dezinfektimin e plagëve dhe uljen e rrezikut nga infeksionet bakteriale dhe kërpudhore.

“Rekomandohet aplikimi i preparateve me bazë bakri për dezinfektimin e plagëve dhe uljen e rrezikut të infeksioneve bakteriale dhe kërpudhore”, thuhet në njoftimin e ministrisë, ku përmenden preparate si hidroksidi i bakrit, oksikloruri i bakrit dhe lëngu Bordolez. Sipas MBPZHR-së, këto preparate krijojnë një shtresë mbrojtëse në sipërfaqet e dëmtuara dhe zvogëlojnë mundësinë e depërtimit të patogjenëve përmes plagëve të shkaktuara nga breshëri. Ministria ka rekomanduar që 2 deri në 5 ditë pas trajtimit fillestar të përdoren biostimulantë për të ndihmuar bimën në tejkalimin e stresit



fiziologjik dhe rigjenerimin e indeve të dëmtuara. Në këtë

fazë fermerëve u sugjerohet përdorimi i aminoacideve, ekstrakteve të algave detare, acideve humike dhe fulvike si dhe preparateve me bazë silici. Po për rikuperimin e pemëve frutore rekomandohet edhe një program i balancuar ushqyes, i cili përfshin kalcium dhe bor për forcimin e indeve të reja, azot në doza të moderuara për rigjenerimin e masës gjethe dhe kalium për rritjen e rezistencës së bimës ndaj stresit. MBPZHR ka bërë thirrje që fermerët ta monitorojnë rregullisht gjendjen e pemëve, pasi pas breshrit rritet rreziku i shfaqjes së sëmundjeve kërpudhore dhe bakteriale. “Trajtimet

fitosanitare duhet të zbatohen sipas vlerësimit të dëmtimeve, kushteve klimatike dhe rekomandimeve për kulturën përkatëse, duke respektuar preparatet e regjistruara dhe udhëzimet e etiketës”, ka bërë me dije ministria. Sipas njoftimit, rekomandimet duhet të përshtaten me llojin e pemës frutore, fazën e zhvillimit, shkallën e dëmtimit dhe kushtet agroklmatike të zonës. Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike i MBPZHR-së i ka inkurajuar fermerët t'i ndjekin praktikatat profesionale bujqësore dhe të kërkojnë këshilla në Qendrat Informative Këshillimore Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

BËHEN PËRGATITJET PËR FORUMIN E TRETË EKONOMIK GJERMANO-KOSOVAR

Prishtinë, 24 korrik - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, zhvilloi një takim koordinues me drejtorin e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Besnik Vasolli, dhe bashkëpunëtorët e tij, ndërsa përmes lidhjes online morën pjesë edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, si dhe konsulli i Republikës së Kosovës në Düsseldorf, Behar Isma. Takimi u fokusua në përgatitjet për organizimin e Forumit të Tretë Ekonomik Gjermano-Kosovar i cili do të mbahet më 28 dhe 29 tetor në Prishtinë. Në kuadër të forumit do të organizohen edhe takime B2B ndërmjet kompanive dhe përfaqësuesve institucionale

nga Kosova dhe Gjermania, me synim krijimin e partneriteteve të reja dhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik. Gjatë takimit u vlerësua se marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë vazhdojnë të jenë të forta dhe të qëndrueshme. Gjermania mbetet partnerja kryesore tregtare e Kosovës dhe destinacioni më i rëndësishëm për eksportet e Kosovës brenda Bashkimit Evropian. Forumi do të fokusohet në tri fusha kryesore: shërbimet digjitale, energjinë dhe infrastrukturën e qëndrueshme, si dhe prodhimin dhe bashkëpunimin industrial. Përmes këtij organizimi synohet krijimi i mundësive të reja për kompanitë dhe shoqatat



gjermane e të Kosovës që të shkëmbejnë përvoja, të ndërtojnë partneritete të reja dhe ta thellojnë bashkëpunimin

ekonomik e industrial në përputhje me nevojat e të dy tregjeve. Kjo qasje është në përputhje me Strategjinë për

Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030 si dhe me zhvillimin e modeleve të reja të eko-parqeve industriale. Dita e dytë e forumit do t'i kushtohet diasporës së Kosovës në Gjermani dhe bizneseve të saj, duke përfshirë edhe masterclass-e të specializuara që do t'u ndihmojnë bizneseve të Kosovës dhe gjermane t'i adresojnë sfidat e rritjes dhe zgjerimit në tregjet ndërkombëtare. Forumi i Tretë Ekonomik Gjermano-Kosovar do të organizohet nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, ndërsa do të mbështetet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit.

HISTORIA: NJUTONI DHE MOLLA, MOMENTI QË NDRYSHOI SHKENCËN PËRGJITHMONË



Njutoni dhe molla që ndryshoi mënyrën si kuptojmë universin

Pak histori në shkencë janë kaq të njohura sa ajo e mollës së Njutonit. Është një skenë që duket e thjeshtë: një njeri i ulur nën një pemë, një mollë që bie, dhe një ide që ndryshon përgjithmonë mënyrën si njerëzimi e kupton botën. Por a ishte vërtet një mollë që i ra në kokë Isaac Newtonit dhe i dha menjëherë formulën e gravitetit? Apo kjo është vetëm një legjendë e bukur që e kemi thjeshtuar me kalimin e kohës? Historia reale është shumë më interesante, dhe shumë më njerëzore.

Njutoni dhe molla, si lindi historia e famshme?

Versioni më i njohur i historisë thotë se Isaac Njtonishte ulur nën hijen e një peme molle kur një frut i ra mbi kokë, duke i dhënë menjëherë idenë e gravitetit. Megjithatë, burimi më i rëndë-

sishëm historik nuk përmend asnjë goditje në kokë. Historia vjen nga një biografi e shkruar në vitin 1752 nga miku i tij, William Stukeley, me titull "Jeta e Sir Isaac Newton". Në këtë libër, Stukeley përshkruan një bisedë që pati me Newtonin në një pasdite të qetë në kopshtin e shtëpisë së tij. Sipas tij, Njutoni tregoi se ideja e gravitetit i erdhi ndërsa po shihte një mollë që binte nga pema. Ai filloi të pyesë veten: "Pse mollët bien gjithmonë drejt tokës?" Kjo pyetje e thjeshtë do të bëhej një nga më të rëndësishmet në historinë e shkencës.

Jo një "eureka" e menjëhershme, por fillimi i një revolucioni

Ndryshe nga legjendat, zbulimi i gravitetit nuk ndodhi brenda një momenti të vetëm. Rënia e mollës nuk i dha Newtonit një formulë magjike, ajo i dha një pyetje. Dhe pyetjet janë motori i shkencës. Njutoni filloi të mendojë nëse

forca që tërhiqte mollën drejt tokës ishte e njëjta forcë që mbante Hënën në orbitë rreth Tokës. Ishte një ide revolucionare: ndoshta e njëjta forcë vepronte kudo në univers. Këto reflektime, të zhvilluara gjatë viteve, çuan në formulimin e Ligjit të Gravitetit Universal, një nga arritjet më të mëdha të mendimit njerëzor.

Dokumenti historik që e konfirmoi historinë

Për shumë kohë, Njutoni dhe molla ishte historia që u konsiderua thjesht një anekdotë. Por dorëshkrimi i Stukeley-t, i ruajtur në arkivat e Royal Society në Londër, ofroi dëshmi të drejtpërdrejta. Dokumenti u bë publik për herë të parë në vitin 2010, duke i lejuar studiuesit dhe publikun të lexonin përshkrimin e Njutonit me fjalët e një dëshmitari të afërt. Astronomi i njohur Martin Rees, president i Royal Society në atë kohë, e përshkroi dorëshkrimin si një burim historik jashtëzakonisht të vlef-

shëm, sepse vjen nga një mik që e njohte personalisht shkencëtarin.

Mit apo realitet? Debatimi që vazhdon edhe sot

Edhe me këtë dëshmi, Njutoni dhe molla është histori që vazhdon të diskutohet. Disa historianë mendojnë se NewNjtoniton mund ta ketë thjeshtuar historinë për ta bërë më të kuptueshme. Të tjerë besojnë se molla është simbolike, një metaforë e momentit të kuptimit. Madje disa lidhin mollën me simbolikën e lashtë të dijes, që nga tregimi biblik i Evës. Por një gjë është e sigurt: nëse mollë kishte apo jo, ideja që ajo përfaqëson është reale. Historia mbetet e pavdekshme sepse përfaqëson një të vërtetë të thellë për shkencën: Zbulimet e mëdha nuk lindin gjithmonë nga eksperimente të ndërlikuara, shpesh ato fillojnë me vëzhgime të thjeshta dhe me një mendje që nuk pushon së pyeturi. Njutoni nuk pa vetëm një mollë

që binte. Ai pa një ligj universal që vepron në të gjithë kozmosin.

Trashëgimia e Njutonit

Isak Njutoni mbetet një nga mendimtarët më të mëdhenj të historisë njerëzore. Punimet e tij formësuan fizikën moderne dhe ndryshuan përgjithmonë mënyrën si kuptojmë natyrën. Poeti Alexander Pope e përmbodhi madhësinë e tij në një epitaf të famshëm: "Natyra dhe ligjet e saj ishin të fshehura në errësirë. Zoti tha: 'Le të bëhet Njutoni!' dhe u bë dritë." Historia e mollës së Njutonit nuk është thjesht një anekdotë e këndshme. Ajo është simboli i një momenti kur njeriu filloi të kuptojë se universi ndjek ligje të qarta, të matshme dhe universale. Një frut që bie nga një pemë është një gjë e zakonshme. Të kuptosh se e njëjta forcë kontrollon lëvizjen e planetëve, kjo është madhështore. Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse historia e mollës nuk do të harrohet kurrë. / bota.al

‘SHQISA E GJASHTË’ EKZISTON VËRTET



Shkenca, megjithatë, preferon ta quajë intuitë. Shqisa e gjashtë nuk ka asnjë lidhje me parandjenja misterioze apo me perceptime jashtëshqisore, por është rezultat i përvojave që kemi fituar më parë. Sa herë na ka ndodhur të mendojmë për një person që nuk e kemi dëgjuar prej kohësh dhe, papritur, ai na telefonon? Ose të përballemi me një sfidë duke pasur një parandjenjë për rezultatin e saj? Ose, sapo t'i shtrëngojmë dorën dikujt që sapo kemi njohur, të ndiejmë menjëherë një afërsi të veçantë me të, ose, përkundrazi, të krijojmë një ndjesi refuzimi?

Këtë e quajmë “shqisa e gjashtë”, një lloj instinkti që drejton në mënyrë të pavetëdijshme veprimet tona. Të tjerë, më saktë, e quajmë intuitë: një aftësi për të arritur njohje të menjëhershme, e cila na çon drejt vendimeve instinktive, pa kaluar përmes arsytimit të vetëdijshëm apo përpunimit logjik të njohurive të fituara.

Edhe Carl Gustav Jung, dishepull i Sigmund Freud, mbronte idenë se ekzistonte një “forcë jetësore” që qëndronte mbi vetëdijen. Tani, një grup shkencëtarësh nga Universiteti Washington në Saint Louis (SHBA) pretendojnë se kanë identifikuar vendndodhjen e saj: “shqisa e gjashtë” ndodhet në korteksin cingular anterior të trurit, një zonë e vendosur mes dy hemisferave cerebrale, e konsideruar si pika ku takohen arsyeja dhe emocionet. Pikërisht për këtë arsye, ajo luan një rol kyç në arsytimet dhe vendimet më të vështira.

Zbulimi, i botuar në revistën shkencore amerikane Science, ka treguar se këtu ndodhet një mekanizëm i sofistikuar i pavetëdijshëm që na udhëheq në përshtatjen e sjelljeve tona, duke deshifruar sinjalet që vijnë nga mjedisi përreth. Në thelb, bëhet fjalë për një mekanizëm vetëmbrojtës, i krijuar për të na mbrojtur nga rreziqet.

E ardhmja përmes së kaluarës

“Përmes përvojës ne zhvillojmë aftësinë për të lexuar dhe interpretuar realitetin që na rrethon, si edhe për të dalluar situata që nuk na janë familjare dhe që mund të na vënë në rrezik,” shpjegon Tiziano Agostini, profesor i Metodologjisë së Kërkimit Psikologjik në Universitetin e Triestes.

“Megjithatë, të flasësh për një ‘shqisë të gjashtë’ është një kundërthënie në vetvete, pasi ne kemi vetëm pesë shqisa. Pikërisht këto na lejojnë të mbledhim informacion nga mjedisi përreth, i cili më pas përpunohet nga truri në bazë të përvojës sonë personale dhe të kontekstit ku ndodhemi.”

Një nga rastet më të zakonshme ndodh në qytet: sa herë na ka ndodhur të kthejmë cepin e një rruge që dukej krejt e sigurt, por papritur të na pushtojë një ndjesi e fortë frike, sikur aty të fshihej një rrezik?

Nuk bëhet fjalë për një aftësi jashtëshqisore që na lejon të parashikojmë të ardhmen, por për një mekanizëm të pavetëdijshëm që rikthen në sipërfaqe përvojat tona të mëparshme – në këtë rast, ato të fituara në mjedisin urban – dhe i ndërthur me informacionin që marrim përmes shqisave (si frekuentimi i rrugës, pamja e zonës, ndriçimi, një heshtje e pazakontë në mes të ditës etj.).

Në këtë mënyrë, ky mekanizëm e dallon menjëherë kur diçka nuk shkon, pa qenë e nevojshme që vetëdija jonë të kuptojë se ajo situatë mund të jetë e rrezikshme. Natyrisht, ky mekanizëm lidhet ngushtë me mjedisin ku jetojmë dhe që e njohim mirë; në kontekste të tjera ai nuk do të funksiononte me të njëjtën efektivitet.

Në të njëjtin përfundim kishte arritur edhe Shoqata Britanike për Avancimin e Shkencës, e cila, pas eksperimenteve të shumta, e kishte përkufizuar “shqisën e gjashtë” si një formë vetëmbrojtjeje që e ka origjinën në të kaluarën tonë si njerëz primitivë, kur aftësia për të dalluar në kohë praninë e një grabitqari ishte çështje jete ose vdekjeje. “Shqisat tona dhe mënyra jonë e të menduarit janë zhvilluar në mjedise të caktuara,” shprehet eksperti, “aq sa edhe sot perceptojmë në mënyrë të pavetëdijshme disa forma si të rrezikshme. Për shembull, alarmohemi kur shohim një siluetë që ngjan me një merimangë ose një gjarpër.”

Diçka më shumë se logjika

Në të kaluarën, koncepti i inteligjencës lidhej kryesisht me logjikën dhe racionalitetin. Sot, përkundrazi, ai ka fituar një dimension të ri dhe sot luan rol edhe në detyra shumë më të gjera, përfshirë zgjidhjen e problemeve me natyrë emocionale ose ndërpersonale. Ky ndryshim ka sjellë një transformim rrënjësor në mënyrën se si mendojmë dhe marrim vendime “me intuitë”. Ndryshe nga bindjet e së kaluarës, kur besojmë se për të marrë një vendim të drejtë duhet domosdoshmërisht të reflektonim gjatë dhe të analizojmë në thellësi çdo element të një situatë, sot vlerësohet gjithnjë e më shumë intelijenca intuitive. Është pikërisht intuita, të cilën shumë njerëz gabimisht e quajmë “shqisa e gjashtë”, ajo që na lejon të vlerësojmë shpejt situata të çdo lloji, pa pasur nevojë t'i analizojmë një për një. Kjo e pengon trurin të mbingarkohet nga informacioni dhe të

humbasë aftësinë për të marrë një vendim.

“Kjo qasje e bazuar në intuitë quhet ‘procedurë heuristike mendore,’ shpjegon profesori Agostini. “Heuristika është një mënyrë intuitive për t’iu qasur problemeve, ku nga pavetëdija rikthehen njohuritë dhe përvojat e grumbulluara gjatë viteve në situata të ndryshme, në mënyrë që ato të na japin udhëzimet më të përshtatshme se si të veprojmë në raste të ngjashme.”

Po ku ndodh i gjithë ky proces në tru? Intelijenca intuitive ka qendrën e saj në sistemin limbik, një pjesë shumë e lashtë e trurit tonë që përpunon dhe menaxhon stimujt që vijnë nga mjedisi.

Kur përballemi me një situatë të rrezikshme ose me një problem që kërkon një zgjidhje të menjëhershme, sistemi limbik rikthen një sërë kujtimesh dhe imazhesh nga situata të ngjashme të përjetuara në të kaluarën, të lidhura me emocione pozitive ose negative.

Kështu shpjegohet ajo ndjesi instinktive, e cila mund të jetë pozitive ose negative, në varësi të emocioneve që zgjon, dhe që na udhëheq drejt vendimit të duhur në momentet vendimtare. Duhet theksuar se kjo nuk ka asnjë lidhje me të ashtuquajturat perceptime jashtëshqisore.

Antipatia me shikim të parë

Le të kthehemi te ajo ndjesi instinktive e simpatisë ose antipatisë ndaj një personi që sapo kemi njohur.

Ajo që na krijon një tablo të personit që kemi përballë është intelijenca emocionale, e cila, nga ana e saj, lidhet në mënyrë të pavetëdijshme me përvojat tona të mëparshme.

“Përballemi me një individ që në disa aspekte na ngjan, por që në të vërtetë është shumë i ndryshëm nga ne dhe ka një sistem njohës të ngjashëm me

tonin, i cili njëkohësisht po na vlerëson edhe ne,” thotë Tiziano Agostini.

“Për të kuptuar personin që kemi përballë, ne përdorim shqisat tona. Përshtypja e parë krijohet nga shikimi. Megjithatë, ndodh shpesh që një person që në pamje të parë nuk na ka pëlqyer, të na duket më i këndshëm sapo fillon të flasë me një zë të butë dhe qetësues, duke e përmbysur kështu përshtypjen tonë fillestare.”


Po nuhatja? “Ne priremi ta nënvlerësojmë rëndësinë e saj, sepse nuk jemi shumë të vetëdijshëm për ndikimin që ka,” përgjigjet specialisti.

“Megjithatë, shqisa e nuhatjes na jep në mënyrë të pavetëdijshme informacione të rëndësishme për personin që kemi përballë dhe për qëllimet e tij. Ajo mund të na tregojë, për shembull, nëse ai po sekreton adrenalinë – hormon që lidhet me frikën dhe agresivitetin – apo feromone, substanca kimike që nxisin tërheqjen seksuale.”

Sa i përket modeleve të sjelljes, na pëlqen ose na krijon refuzim një person në varësi të përvojave tona të mëparshme me individë të ngjashëm që kemi takuar gjatë jetës, përvoja të cilat rikthehen nga pavetëdija dhe ripërpunohen nga truri.

Natyrisht, ky mekanizëm vlen vetëm brenda kontekstit tonë gjeografik dhe kulturor.

Le të marrim si shembull shtrëngimin e parë të duarve me një person. Është e vërtetë se ai na jep të dhëna të rëndësishme. Por nëse takojmë një japonez, kodet e sjelljes së të cilit janë të ndryshme nga tonat dhe që nuk është mësuar ta përdorë shtrëngimin e dorës si formë përshëndetjeje, do të mbetemi të hutuar, sepse informacioni që do të marrim prej këtij gjesti nuk do të jetë aspak i qartë. Ose, në disa raste, nuk do të marrim fare informacion. / bota.al



Prenga dhe Joshua matin forcat sonte në ring

JEDDAH, 24 KORRIK - Boksieri shqiptar Kristian Prenga ka dërguar një mesazh plot besim në konferencën për medie para përballjes me Anthony Joshua, e cila zhvillohet sot (e shtunë) në Jeddah të Arabisë Saudite. Prenga ka thënë se është gati

për sfidën më të rëndësishme të karrierës së tij. "Kam punuar gjithë jetën për këtë, kam prituri gjithë jetën për këtë dhe shpresoj që të shtunën do t'i tregoj botës se kush jam", është shprehur Prenga para gazetarëve, duke reflektuar besimin dhe motivimin me të

cilin do të ngjitet në ring. Boksieri shqiptar do të përballlet me ish-kampionin e botës në peshat e rënda, Anthony Joshua, në një duel që pritet me interes të madh nga tifozët e boksit. Meçi mes dy peshave të rënda është programuar me fillim

nga ora 22:00. Për Prengën kjo është mundësia ideale për t'i dëshmuar vlerat në skenën më të madhe të boksit profesionist, ndërsa një fitore ndaj Joshuas do ta shënonte momentin më të rëndësishëm në karrierën e tij.



Boksieri shqiptar numëron 20 fitore dhe vetëm një humbje në karrierën profesioniste. Të gjitha fitoret i ka me nokaut.

MALISHEVA SHKËLQEN NDAJ HIBERNIANIT, DUKAGJINI PËSON HUMBJE MINIMALE NË LUGANO

PRISHTINË, 24 KORRIK - Malisheva ka shënuar fitore të madhe në garat evropiane, ndërsa Dukagjini ka pësuar humbje minimale në ndeshjen e parë të raundit të dytë kualifikues të UEFA Conference League. Në stadiumin "Fadil Vokrri" Malisheva e ka mposhtur 2:0 skuadrën skoceze Hibernian, duke krijuar një epërsi të rëndësishme para ndeshjes së kthimit, e cila do të zhvillohet pas një jave në Skoci. Kreshnik Uka ishte protagonist i fitores së Malishevës, duke shënuar golin e parë në minutën e 21-të pas asistimit të Arlind Veliut. Në fund të takimit, Uka ka asistuar për Valmir Nafiun, i cili në minutën e 90 ka vulosur fitoren 2:0 të skuadrës së drejtuar

nga Thomas Bërdariq. Malisheva është shumë pranë një tjetër arritjeje historike në Evropë. Në raundin e parë kualifikues skuadra eliminoi Vllazninë e Shkodrës me rezultat të përgjithshëm 6:2. Në rast kualifikimi ndaj Hibernianit, Malisheva në raundin e tretë do të përballlet me fituesin e çiftit Bravo - Shkëndija e Tetovës. Ndërsa Dukagjini është mposhtur 1:0 nga Lugano në Zvicër. Golin e vetëm të ndeshjes e ka realizuar Renato Steffen në minutën e 31-të. Skuadra nga Klina kishte mundësi ta barazonte rezultatin, me Jeudi Stevenson që goditi shtyllën në minutën e 65-të, ndërsa Mërgim Pefqeli ishte pranë golit në fund të takimit.



Dukagjini nga minuta e 87 ka luajtur me një lojtar më pak pas kartonit të kuq të Arvanit Rexhaj. Ndeshjet e kthimit do të zhvillohen pas një jave. Malisheva do të synojë ta mbrojë

avantazhin prej dy golash, ndërsa Dukagjini do të kërkojë përmbysjen në shtëpi për ta siguruar kualifikimin në raundin e tretë të UEFA Conference League.

Kloppi emërohet trajner i Gjermanisë



BERLIN, 24 KORRIK - Jurgen Kloppi rikthehet në skenën e futbollit, duke marrë drejtimin e Kombëtares së Gjermanisë. 52-vjeçari është zyrtarizuar të premten përzgjedhës i "Pancerëve", pasi ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me Federatën Gjermane të Futbollit (DFB). Klopp, i cili udhëhoqi Liverpoolin deri vitin e kaluar, kishte vendosur të pushonte dhe të qëndronte larg futbollit, por nuk ka mundur ta refuzojë ofertën për ta drejtuar kombëtaren e vendit të tij. Në konferencën për medie Kloppi ka thënë se ndihet i nderuar për këtë detyrë të madhe, të cilën, siç është shprehur ai, nuk e kishte paramenduar, por ka një ide të qartë se si ta rikthejë kombëtaren gjermane në rrugën e suksesit. Gjermania nuk ka arritur rezultate të kënaqshme në turnetë e mëdha që nga viti 2016, kur ishte eliminuar në gjysmëfinale të Kampionatit Evropian, ndërsa në botërorët e fundit është eliminuar në fazat e hershme. Kloppi do ta nisë zyrtarisht detyrën më 15 gusht, ndërsa ndeshjet e para do t'i zhvillojë në kuadër të Ligës së Kombeve. Kontrata e tij është e vlefshme deri pas përfundimit të Kupës së Botës 2030.

RREGULL I RI, AKTIVIZIM I DETYRUESHËM I LOJTARËVE TË RINJ NË SHQIPËRI

TIRANË, 24 KORRIK - Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF) ka miratuar rregullin për aktivizimin e detyrueshëm të lojtarëve të rinj në kampionatet kombëtare i cili do të hyjë në fuqi duke nisur nga sezoni sportiv 2026-2027. Ky vendim është pjesë e strategjisë së FShF-së për zhvillimin e futbollit shqiptar, rritjen e mundësive për futbollistët e rinj dhe krijimin e një baze më të fortë për ekipet kombëtare. Gjithashtu, ky rregull përveçse synon rritjen e aktivizimit të futbollistëve të rinj shqiptarë në kampionatet kombëtare, rritjen e konkurrencës ndërmjet futbollistëve vendas, ka për qëllim krijimin e një modeli të



qëndrueshëm zhvillimi për dekadën e ardhshme. Sipas rregullores së miratuar, në kampionatin Abissnet Superiore dhe në Kupën e Shqipërisë, çdo skuadër do të ketë detyrimin të aktivizojë nga minuta e parë, për të paktën një pjesë loje, një futbollist të datëlindjes 2007 e në

vijim, me pasaportë shqiptare. Ndërkohë, në Kategorinë e Parë, Kategorinë e Dytë dhe Kategorinë e Tretë, klubet do të duhet të aktivizojnë nga fillimi i ndeshjes të paktën një lojtar të datëlindjes 2007 e në vijim, me pasaportë shqiptare, i cili duhet të luajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndeshjes,

përveç rasteve të parashikuara nga rregullorja. Rregullorja përcakton gjithashtu se, në rast zëvendësimi të lojtarit që plotëson kriteret, ai duhet të zëvendësohet me një tjetër futbollist që përmbush të njëjtat kriteret të moshës dhe shtetësisë. Nëse kjo nuk është e mundur, skuadra do të vazhdojë ndeshjen me një lojtar më pak për periudhën gjatë së cilës ekziston detyrimi i aktivizimit të futbollistit të ri. Rregulli do të zbatohet për të gjitha ndeshjet e kampionateve përkatëse, si edhe për Kupën e Shqipërisë. Klubet janë përgjegjëse për regjistrimin e lojtarëve dhe respektimin e dispozitave të rregullores.

Ronaldo: Spanja luan sot futbollin më të mirë në botë

BRASILIA, 24 KORRIK - Legjenda braziliane Ronaldo ka vlerësuar lart paraqitjet e Spanjës, duke e cilësuar atë si kombëtaren që luan futbollin më të mirë në botë. Duke

komentuar finalen e Kupës së Botës, Ronaldo ka thënë se Spanja ka dominuar ndaj Argentinës dhe se diferenca në cilësi mes dy skuadrave ishte e dukshme. "Spanja ka

ADN futbollistike dhe një stil të bukur loje. Mënyra se si luan sot është më e mira", është shprehur legjenda braziliane. Ai ka thënë se Argjentina nuk ka treguar të

njëjtin shpirt luftarak që e kishte karakterizuar gjatë gjithë turneut, ndërsa ka vlerësuar dominimin e Spanjës nga fillimi deri në fund të finales.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom

Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 24.07.2026

Referenca: AAPSK 008/2026

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf II ngjyrë e kuqe- për skrap-Rishpallje.	1 copë/ për skrap	160.10€		
2	VW Golf II ,ngjyre vishnje viti i prodhimit 1987, dizel-targa vendore-Rishpallje	1 copë	225.00€		
3	Motoçikletë Kawasaki Z300. ngjyrë hiri, viti i prodhimit 2016, benzin, sipas tregut të huaj	1 copë-	1,700.00€		
4	VW Touran 1T, ngjyrë e bardhë viti i prodhimit 2003, dizel-targa vendore	1 copë	3,700.00€		
5	Furgon VW 70XOA,ngjyrë e kaltër, viti i prodhimit 1993, dizel- pë pjesë	1 copë/ për pjesë-	300.00€		
6	Opel Vektra, ngjyrë e kuqe, viti i prodhimit 1989, benzin- për skrap	1 copë/ për skrap	255.00€		
7	Ford Fiesta 1.3 Flair, ngjyrë e kaltër, viti i prodhimit 2001,benzin- për skrap	1 copë/ për skrap	227.70€		
8	Golf III 1.9, ngjyrë e kuqe, viti i prodhimit 1995, dizel- për skrap	1 copë/ për skrap	257.60€		


Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri me **30.07.2026 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.**

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **30.07.2026, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë,**

Kurse të interesuarit mallin me numer rendor **5** mund ta shikojnë me datë: **29.07.2026, prej orës 10:00-11:00 në hapsirat e Qendres Korrektuese në Smrekovnicë- Vushtrri**

Pasuritë e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



KOMPANIA REGIONALE

PASTRIMI

PRISHTINE

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Njoftim për vazhdim të afatit të konkursit


KRM “Pastrimi” vazhdon afatin e konkursit publik me afat të caktuar, për pozitën Punëtor Sezonal të Bartjes në NJO Prishtinë, deri më datën 27/07/2026.

KRM “Pastrimi” më datën 20/07/2026 ka hapur konkursin për gjashtë (10) pozita “Punëtor Sezonal i Bartjes” në NJO Prishtinë dhe është mbyllur në datën 22/07/2026.

Obaveštenje o produženju roka konkursa

KRM „Pastrimi“ produžava rok javnog konkursa na određeno vreme za poziciju Sezonski radnik na iznošenju smeća u OJU Priština, do 27. 07. 2026. godine.

KRM „Pastrimi“ je dana 20. 07. 2026. godine otvorila konkurs za deset (10) radnih mesta „Sezonski radnik na iznošenju smeća“ u OJU Priština, koji je bio zatvoren dana 22. 07. 2026. godine.



Gjej PUNË

• Lajme nga tregu i punes

• Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

– CV-së

– Letrën Motivuese

– Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

0610515308
24-07-2026

F2.2 / BNJ-KP / PT

REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnim odnosima u RPO "Pastrimi" A.D., posebno član 11, stav 1.2 i član 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "Pastrimi" A.D, na osnovu Odluke Upravnog odbora br. Protokol 01/14/37 od 02/09/2025, na osnovu Odluke EK br. Protokol 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke EK o ispitnim pozicijama br. protokol 7096 od 15.11.2024. godine, na osnovu Rešenja od 23.07.2026. godine sa brojem protokola 02/01/433 Generalnog direktora RPO "Pastrimi" d.o.o. Ah, izjavite ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla: Ispravljač

Traženi broj: Jedna (1) pozicija, NJO Lipjan u RPO "Pastrimi" A.D

Referentni broj: KP / PT / NJOL / 19-2026

Koeficijent / Mesečna plata: Nivo XI

Trajanje ugovora o radu: Stalno

Probni period: 3 meseca

Školarina: Srednje obrazovanje

Radno iskustvo: 1 godina radnog iskustva

1. Dužnosti i odgovornosti:

1.1 Nakon prijema zadataka od supervizora, oni se moraju obavezati da će ih izvršiti kako bi osigurali otklanjanje neispravnih nedostataka na osnovu radnog naloga;

1.2 Dužan je da pažljivo pročita radni nalog i dopuni podatke koji se od njega traže u radnom nalogu ili drugim relevantnim delegiranim izveštajima;

1.3 Napunjen je delovima i radnim alatima koji se traže iz skladišta i mora voditi računa o njihovoj čistoći / funkcionalnosti poštujući procedure prihvatanja-doziranja;

1.4 U odsustvu napunjenih alata ili opreme, radnik je dužan da ih nadoknadi u skladu sa internim procedurama;

1.5 Obavlja električno i gasno zavarivanje svih delova i komponenti, sečenje delova zavarivanjem;

1.6 vrši održavanje i mehaničku popravku karoserije vozila, popravlja držače retrovizora, popravke izduvnih cevi, zamenu i popravku konstrukcija sedišta vozila, delova osovina vozila, kočionihi ploča i raznih delova repova vozila prema potrebama i zahtevima supervizora smene;

1.7 Obavlja različite zadatke po potrebi sa drugim jedinicama;

1.8 Za potrebe i neophodne materijale, uvek obaveštava menadžera smene i uvek obezbeđuje da se materijali naručuju unapred;

1.9 Odgovoran je ukoliko zbog nedostatka obaveštenja ili zakašnjelog obavješćavanja zbog nedostatka materijala ili druge opreme dođe do kašnjenja u radu u jedinici, odnosno u Sektoru;

1.10 sprovođi radni nalog i potvrđuje da je posao obavljen po tehničkim standardima;

1.11 Radnik mora prvo osigurati da ima potrebno znanje za pristup poslu opisanom u radnom nalogu;

1.12 Radnik je odgovoran ako vidi da je intervencija apsolutno neophodna i izbegava tu akciju zanemarujući rad;

1.13 Za sve druge poslove za koje radnik primeti da treba da se obavljaju pored poslova iz radnog naloga, oni unapred obaveštavaju rukovodioca smjene i dobijaju dozvolu za postupanje preuzimanjem istog posla putem radnog naloga;

1.14 U slučajevima kada je raspored rada potreban za određene popravke, oni traže pomoć od supervizora smjene;

1.15 Nedostaci koje je radnik prouzrokovao tokom popravke zbog nemara ili prekomerne sile biće obrađeni za naknadu štete od strane radnika u skladu sa internim procedurama;

1.16 prati i poštuje kalendar održavanja u skladu sa delegiranim nalogima ili rutinskim zadacima;

1.17 Odgovoran je za popravku rezervnih delova ili druge opreme prema uputstvima nadređenih;

1.18 Poštuje uniformu i uvek nosi ličnu zaštitnu opremu;

1.19 On je odgovoran za brze i profesionalne popravke, bez namernih odlaganja; nalazi iz popravke su detaljno opisani u radnom nalogu;

1.20 Proverava stanje radnog prostora i odgovoran je za čistoću u radionici čak i bez posebnog naloga za čišćenje radnih mesta;

1.21 Angažuje se i reaguje za dobrobit kompanije čak i bez radnog naloga kad god vidi potrebu ili u slučajevima kada primeti da je imovina kompanije oštećena;

1.22 Pomaže kolegu (kolegama) u skladu sa radnim nalogom, uputstvima nadređenih, ili po potrebi;

1.23 Evidentira potrošnju materijala i rezervnih delova i odgovoran je za njih nakon utovara iz skladišta, opravdava ugradnju svakog dela, i obezbeđuje očuvanje materijala prateći prateće procedure;

1.24 obavlja i druge poslove koji se odnose na opisivanje radnih zadataka koje zahtevaju supervizori;

1.25 Za svoj rad odgovara rukovodiocu Operativne jedinice.

2. Opšti kriterijumi za zapošljavanje:

✓ Mora biti državljanin Republike Kosovo,

✓ mora vladati najmanje jednim od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;

✓ Mora biti sposoban za obavljanje odgovarajuće dužnosti;

✓ Da nije osuđen za počinjenje krivičnog dela;

✓ Ne smije postojati disciplinska mjera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;

✓ Mora imati vještine potrebne za poziciju

✓ Da uspešno prođe procedure prijema definisane zakonom.

3. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

✓ Biti oprezan i obratiti pažnju na detalje;

✓ Sposobnost samostalnog rada;

✓ Veštine korisničkog servisa;

✓ Poznavanje javne bezbednosti;

✓ Sposobnost da dobro rade sa rukama;

✓ Fizička spremnost i izdržljivost;

✓ Sposobnost organizovanja vremena i radnog opterećenja;

✓ Dobre veštine verbalne komunikacije.

4. Dokumenti koji se dostavljaju u okviru prijave i način njihovog podnošenja

Prijava za zapošljavanje i biografija, popunjen i potpisan od strane kandidata	✓
Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova	✓
Kopija dokaza o zapošljavanju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (opcionarno)	✓
Kopije ocena rada za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Identifikacioni dokument Republike Kosovo	✓
Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci	✓

4.1 Forma javnog takmičenja bez testiranja (KP/PT):

-Konkurs za ovo radno mesto se sprovodi po posebnom postupku, bez pismenog testa, i obuhvata samo ocjenu CV-a i stručni intervju.

5. Postupak prijave na konkurs i podnošenje prijave:

5.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:

* preuzimanjem sa zvanične Facebook stranice: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" Sh. A.
* na recepciji kompanije.

5.2 Podnošenje prijave:

* Zahtevi za zapošljavanje, sa kompletnom dokumentacijom, podnose se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i
* U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i fizički preko arhive kompanije.

6. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;

Javni konkurs traje 15 dana od 25.07.2026. do 10.08.2026. godine.

Rok za podnošenje prijava je 16:00 časova.

Sve prijave podnesene nakon isteka roka neće se razmatrati.

7. Metod evaluacije i kriterijumi bodovanja.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvarivanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza javnog konkursa.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ CV kandidata: do 25 bodova
- ✓ Intervju: do 75 bodova.

8. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

9. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Preliminarna verifikacijska faza prijava do 7 dana;

Faza pismenog testiranja traje do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjuja traje do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Rezultati se objavljuju do 3 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nepotpuna ili neskenirana dokumenta, kao i ona koja stignu nakon isteka roka za takmičenje, neće se razmatrati.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abirapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L